



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 84

Tiranë – E enjte, 19 maj 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 46/2016 datë 28.4.2016	Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve, në zbatim të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4653
Ligj nr. 47/2016 datë 28.4.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar.....	4654
Ligj nr. 48/2016 datë 5.5.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.....	4665
Ligj nr. 50/2016 datë 5.5.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”.....	4668



**LIGJ**  
**Nr. 46/2016**

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE QË KANË  
ISH-USHTARAKËT NË SKEMËN  
E PENSIONEVE SUPLEMENTARE, NGA  
RILLOGARITJA E PENSIONEVE, NË  
ZBATIM TË LIGJIT NR. 10142, DATË  
15.5.2009, “PËR SIGURIMIN SHOQËROR  
SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË  
FORCAVE TË ARMATOSURA,  
TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË  
SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS,  
TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË  
SHTETIT, TË POLICISË SË BURGJEVE,  
TË POLICISË SË MBROJTJES NGA  
ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË  
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË  
KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**VENDOSI:**

**Neni 1**

1. Falen detyrimet e papaguara, që kanë rrjedhur nga rillogaritja e pensioneve, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 10 367, datë 23.12.2010, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 10.11.2010, “ Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të

Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, sipas gjendjes së tyre në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Shumat e detyrimeve të krijuara nga rillogaritja e pensioneve, sipas pikës 1, të këtij neni, të paguara nga personat përfitues, në harkun kohor dhjetor 2010 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u kthehen personave që u janë mbajtur, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 2**

Detyrimet e ushtarakëve, që janë krijuar si pasojë e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për njohje të masës së përfitimit pas datës 1.7.2009, në kundërshtim me formulën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm, të përcaktuar sipas ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk falen.

**Neni 3**

Falen detyrimet që do të krijohen si pasojë e rillogaritjes së pensioneve, sipas dispozitave të ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për ata ushtarakë, për të cilët rillogaritja nuk është kryer deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 4**

Brenda 3 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për rillogaritjen e përfitimeve. Me përfundimin e këtij afati, detyrimet që rrjedhin nga rillogaritja nuk falen.



## Neni 5

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij ligji. Procedurat e zbatimit të faljes së detyrimeve të papaguara miratohen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe zbatohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

## Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e nenit 1 të këtij ligji.

## Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 28.4.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9598, datë 16.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 47/2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË LIGJIN NR. 10 091, DATË 5.3.2009,  
“PËR AUDITIMIN LIGJOR,  
ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË  
EKSPERTIT KONTABËL TË  
REGJISTRUAR DHE TË KONTABILISTIT  
TË MIRATUAR”, TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

<sup>1</sup> Ky ligj është përfaqësuar pjesërisht me:

- Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 maj 2006, “Mbi auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, amendimin e direktivave të Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 84/253/KEE”, e amenduar, Celex: 32006L0043; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 157, datë 9.6.2006, faqe 87–107;

- Rregulloren (BE) nr. 537/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014, “Mbi kërkesat specifike në lidhje me auditimin e njësive me interes publik dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit 2005/909/KE”, Celex: 32014R0537, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 158, datë 27.5.2014, faqe 77–112.

## KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

## Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:

“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”.

## Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Auditim ligjor” është një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara, nëse:

a) kërkohet nga ky ligj;

b) kërkohet nga ligje të tjera;

c) kryhet në mënyrë vullnetare, me kërkesë të ortakëve/aksionarëve të njësive ekonomike të biznesit ose nga palë të tjera të interesuara, kur për auditimin ligjor zbatohen standarde dhe kërkesa të legjislacionit, të barasvlershme me ato që kërkohen për një auditim ligjor, sipas shkronjës “a” të kësaj pike.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. “Auditues i grupit” është një ose disa auditues ligjorë apo një ose disa shoqëri auditimi, që kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. “Komision i provimeve të aftësive profesionale” është struktura që merret me testimet e kandidatëve për auditues ligjorë dhe kontabilistë të miratuar, të cilat organizohen në kuadër të provimit përfundimtar dhe me shpalljen e rezultateve.”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “Komiteti i regjistrimit” është struktura e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, që merret me procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit.”.



5. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. “Bordi i Mbikëqyrjes Publike” është organi kolegial i mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, i cili ka, gjithashtu, kompetenca edhe për mbikëqyrjen e organizmave profesionale të kontabilistëve të miratuar.”.

6. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. “Auditues ligjor” është individ i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”.

7. Pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13. “Jopraktikues” është çdo individ me njohuri në fushën e auditimit ligjor dhe në fusha të lidhura me të, i cili, gjatë angazhimit në qeverisjen e sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe për periudhën e fundit trevjeçare, përpara këtij angazhimi, nuk ka kryer auditime ligjore, nuk ka pasur të drejtë vote në një shoqëri auditimi, nuk ka qenë anëtar i organit administrativ, mbikëqyrës apo drejtues i një shoqërie auditimi dhe nuk ka qenë i punësuar apo i angazhuar në forma të tjera në një shoqëri auditimi.”.

8. Pika 20 ndryshohet si më poshtë:

“20. “Shoqëri auditimi” është një person juridik, pavarësisht formës së organizimit, i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore dhe që plotëson kriteret e parashikuara në këtë ligj.”.

9. Pas pikës 22 shtohet pika 23 me këtë përmbajtje:

“23. “Njësi ekonomike me interes publik” janë:

a) të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;

b) bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

c) shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;

ç) shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

### **Bordi i Mbikëqyrjes Publike**

1. Për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë, krijohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur.

2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike përbëhet nga 5 anëtarë jopraktikues, të cilët kanë njohuri për auditimin ligjor dhe fusha të lidhura me të.

3. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë, si më poshtë:

a) kryetari dhe tre anëtarë propozohen nga Ministri i Financave, njëri prej të cilëve përzgjidhet nga institucionet e arsimit të lartë;

b) një anëtar propozohet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

4. Anëtarët e bordit përzgjidhen sipas një procedure transparente dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë shtetësi shqiptare;

b) të kenë integritet moral dhe profesional;

c) të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;

ç) të zotërojnë, të paktën, diplomë “Master i shkencave” apo të barasvlershëm me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 10 vite përvojë, ose një gradë apo titull shkencor dhe 7 vite përvojë pune në çështjet e auditimit ligjor dhe të kontabilitetit;

d) të mos kenë lidhje të afërta, deri në shkallë të dytë, me personat në organet e zgjedhura të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

5. Bordi, në ushtrimin e funksioneve të veta mbikëqyrëse, të sigurimit të cilësisë dhe administrative, asistohet nga një strukturë mbështetëse. Punonjësit e kësaj strukture, që do të angazhohen në kontrollin e sigurimit të cilësisë duhet të plotësojnë, të paktën, kriteret e mëposhtme:

a) të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të kenë jo më pak se



10 vjet përvojë pune në fushën e auditimit ligjor e të raportimit financiar, kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së cilësisë;

b) të mos ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor dhe të mos jenë të punësuar apo të angazhuar me një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;

c) të mos kenë konflikt interesi ndërmjet tyre dhe me audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit. Këta punonjës, përpara nisjes së procesit të sigurimit të cilësisë, plotësojnë një deklaratë me shkrim, ku deklarojnë se nuk janë në konflikt interesi me audituesin ligjor dhe/ose shoqërinë e auditimit, objekt të kontrollit të cilësisë.

6. Si përjashtim i shkronjës “b”, të pikës 5, të këtij neni, bordi mund të asistohet nga ekspertë për të kryer kontrole cilësie specifike, në rastet kur:

a) numri i punonjësve të strukturës mbështetëse, që mbulojnë çështjet e dhënies së sigurisë për cilësinë është i pamjaftueshëm;

b) kur kjo konsiderohet thelbësore për kryerjen, në mënyrën e duhur, të kontrollit të cilësisë.

Ekspertët që angazhohen duhet të plotësojnë kërkesat e pikës 5, të këtij neni, dhe nuk duhet të jenë të përfshirë në qeverisjen ose të punësuar apo të kontraktuar në organizata të tjera profesionale, por mund të jenë anëtarë të këtyre organizatave.

7. Punonjësit që mbulojnë çështjet e sigurimit të cilësisë nuk mund të kryejnë kontroll cilësie për një auditues ligjor ose shoqëri auditimi derisa të kenë kaluar, të paktën, tre vjet që nga momenti që ky person ka pushuar së qeni partner, i punësuar, apo i lidhur me këtë auditues ligjor apo shoqëri auditimi.

8. Organika e strukturës mbështetëse miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të strukturës mbështetëse rregullohen në përputhje me Kodin e Punës.

9. Këshilli i Ministrave miraton:

a) procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve të bordit;

b) rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;

c) shpërblimin e anëtarëve të bordit;

ç) mënyrën e funksionimit dhe nivelin e pagave të strukturës mbështetëse.”

Neni 4

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

### Financimi i Bordit të Mbikëqyrjes Publike

1. Financimi i veprimtarisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike bëhet:

a) nëpërmjet të ardhurave të mbledhura nga:

i) pagesa prej 3 për qind, e caktuar mbi shumën e honorarit të faturuar për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik, të paguara nga shoqëritë audituese/audituesit ligjorë, që kryejnë auditime të njësive ekonomike me interes publik;

ii) fonde të tjera, që vijnë nëpërmjet kontributit të organizatave të tjera profesionale, subjekt i mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;

iii) shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, subjekt të masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;

iv) teprica të papërdorura nga proceset e provimit përfundimtar të kandidatëve për kontabilistë të miratuar dhe auditues ligjorë;

v) fonde të tjera, nga burime të ligjshme, të pandikuara nga audituesit ligjorë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, grantet e akorduara në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit;

b) nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, sipas përcaktimeve në ligjin vjetor të buxhetit.

2. Të ardhurat e siguruar, sipas pikës 1, të këtij neni, përdoren nga bordi për financimin e veprimtarisë e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Teprica e të ardhurave, në fund të vitit buxhetor aktual, kalon në reduktim të masës së financimit nga Buxheti i Shtetit për vitin pasardhës.

3. Procedura dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, hartohen dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Shuma prej 30 për qind e të ardhurave të arkëtuara nga gjambat derdhet në buxhetin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.”

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

### Raportimi

1. Bordi i dërgon Ministrin të Financave, një herë në vit, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, një raport me shkrim, në të cilin bëhet një përmbledhje e jepen detaje për problemet e



hasura nga audituesit ligjorë, masat e marra dhe zgjidhjet e dhëna.

2. Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.”

#### Neni 6

Në nenin 9, pika 1, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) me votim të fshehtë zgjedh anëtarët e këshillit drejtues, ndër individët që kanë paraqitur kandidaturën për këto poste, të cilët më pas zgjedhin kryetarin, zëvendëskryetarin dhe drejtorin ekzekutiv, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në statutin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.”

2. Shkronja “c” shfuqizohet.

#### Neni 7

Në nenin 10, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Anëtarët e tjerë të këshillit drejtues zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm pas kalimit të një afati katërvjeçar nga përfundimi i mandatit.”

#### Neni 8

Në nenin 12, pika 2, shkronjat “a” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) harton kurrikulat për programin e përgatitjes dhe trajnimeve profesionale për kandidatët që kërkojnë të hyjnë në profesion, bazuar në standardet e pranuar ndërkombëtare të edukimit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël, dhe organizon e monitoron procesin e trajnimit;

c) harton programet e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të tij, përcakton rregullat për organizimin dhe monitorimin e kualifikimit të vijueshëm të tyre, ku përfshihen mënyrat dhe format e kryerjes së trajnimit, monitorimi, njohja dhe ekuivalentimi i formave të ndryshme të trajnimit, që realizohen nga palë të treta, si dhe organizon e monitoron kualifikimin e vijueshëm.”

#### Neni 9

Në nenin 15 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përpara se të testohet në provimin përfundimtar për marrjen e titullit “Auditues ligjor”, me qëllim që të regjistrohet në regjistrin publik të audituesve ligjorë, kandidati duhet të ketë:

a) përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë ligj për hyrjen në profesion;

b) kaluar me sukses të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes profesionale, të hartuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji;

c) kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 vjet, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi të njohur në Republikën e Shqipërisë, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim.

Të paktën, dy të tretat e kësaj praktike profesionale duhet të kryhen pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie audituese, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.”

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Organizata profesionale e audituesve ligjorë, sipas kompetencave të parashikuara në statut, siguron që stazhi të kryhet në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.”

3. Në pikën 6, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“6. Përfshihen vetëm nga detyrimi për të kryer praktikën profesionale, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, individët që, për pesëmbëdhjetë vjet, kanë qenë të angazhuar në veprimtari profesionale, të cilat u kanë dhënë mundësi të fitojnë përvojën e mjaftueshme në fushën e kontabilitetit, auditimit, financës dhe legjislacionit.”

#### Neni 10

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c” shfuqizohet.

2. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master”, ose të zotërojë diplomë universitare të ekuiva-



lentuar me këtë nivel për çdonjerën nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomik apo të barasvlershme me to.”.

Neni 11

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

### **Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale**

1. Për të realizuar testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjorë, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike ngrihet dhe funksionon Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP).

2. Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike për një periudhë katërvjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:

- a) kryetari nga Ministri i Financave;
- b) dy anëtarë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- c) një anëtar nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- ç) një anëtar nga profesori i fushës të universiteteve.

3. Përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, duhet të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës, të lidhura me auditimin, kontabilitetin e financën, me përvojë profesionale jo më të vogël se dhjetë vjet, ose 7 vite përvojë pune, në rast se mbajnë një gradë apo titull shkencor.”.

4. Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale merret me zbatimin e procedurave të testimit, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve që kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

5. Rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale hartohen dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

6. Rregullat, procedurat e testimit dhe sistemi i vlerësimit për çdo disiplinë të parashikuar në nenin

18, të këtij ligji, propozohen nga organizata e audituesve ligjorë dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

7. Sekretaria teknike për organizimin e provimit përfundimtar kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nën mbikëqyrjen e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.”.

Neni 12

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

### **Provimi i aftësive profesionale**

1. Për të kryer testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, kandidatët duhet t'i drejtojnë kërkesë me shkrim Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale, e cila depozitohet pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Ajo duhet të shoqërohet me dokumentet e nevojshme, që tregojnë përmbushjen e kërkesave dhe pranimin në praktikën profesionale, ose që kandidati ka fituar të drejtën e përjashtimit nga kryerja e praktikës profesionale.

2. Të gjitha testet për njohuritë e aftësive profesionale duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të edukimit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël (IAESB). Sistemi i provimeve të aftësive teorike profesionale duhet të përfshijë, në veçanti, disiplinat:

- a) teori dhe parime të kontabilitetit;
- b) kërkesat ligjore dhe standardet për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të konsoliduara;
- c) standardet ndërkombëtare të kontabilitetit;
- ç) analizë financiare;
- d) kontabilitet kostoje dhe drejtimi;
- dh) menaxhim risku dhe kontroll i brendshëm;
- e) auditimi dhe aftësitë/zotësitë profesionale;
- ë) kërkesat ligjore dhe standardet profesionale për auditimin ligjor dhe audituesit ligjorë;
- f) standardet ndërkombëtare të auditimit;
- g) etika profesionale dhe pavarësia.

3. Sistemi i testimit duhet të mbulojë, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, edhe disiplinat e mëposhtme:

- a) legjislacioni për shoqëritë tregtare dhe qeverisja e shoqërive tregtare;
- b) legjislacioni dhe procedurat e falimentimit;
- c) legjislacioni fiskal në Republikën e Shqipërisë;
- ç) e drejta civile;



d) legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe e drejta e punës në Republikën e Shqipërisë;

dh) teknologjia e informacionit dhe sistemet kompjuterike;

e) ekonomiks;

ë) matematikë dhe statistikë;

f) parimet bazë të menaxhimit financiar.

Programi i përgatitjes profesionale hartohet çdo vit nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.

4. Përpara se të marrin pjesë në testimet e parashikuara në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, kandidatët duhet të provojnë se kanë kaluar me sukses të gjitha provimet e aftësive teorike profesionale, që përfshihen në programin e miratuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, të hartuar sipas kërkesave të pikave 2 e 3, të këtij neni. Për të gjitha ato disiplina, që nuk janë trajtuar nga institucionet përkatëse të arsimit të lartë, organizohen provime të veçanta nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, me të cilat ajo ka nënshkruar marrëveshje.

5. Provimi përfundimtar i aftësive profesionale garanton shkallën e nevojshme të njohurive teorike rreth disiplinave që lidhen me auditimin ligjor dhe aftësinë për të vënë në praktikë njohuri të tilla. Ai realizohet nëpërmjet jo më pak se 4 testeve me shkrim dhe përfshin vlerësimin e aftësive të kandidatëve për auditues ligjorë, për të zbatuar në praktikë e për të bërë gjykime profesionale në një shkallë të avancuar, në fushat e mëposhtme:

a) raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndër-kombëtare të raportimit financiar;

b) zbatimimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare;

c) zbatimimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë;

ç) zbatimimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit;

d) zbatimimi i modeleve të duhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike të biznesit (personave juridikë);

dh) përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës.

6. Testimet, në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, zhvillohen, të paktën, një herë në vit, në datat e miratuara nga Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale.

7. Kandidatët që kanë fituar titullin “Kontabilist i miratuar”, pasi kanë kaluar testet e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, që parashikohen në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij neni, kalojnë drejtpërdrejt në testet e disiplinave të tjera të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d”, dhe “dh”, të pikës 5, të këtij neni, nëse kanë plotësuar kërkesat e parashikuara në nenin 15, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, dhe kushtet dhe programi i provimeve të dhëna nuk kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme, për shkak të ndryshimeve thelbësore të legjislacionit të përfshirë në këto nënndarje.

8. Kostot administrative të organizimit të testimit përballohen nga kandidatët.

9. Shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë kaluar një provim universitar apo ekuivalent, ose kanë një diplomë universitare apo kualifikim ekuivalent në një apo më shumë nga disiplinat e përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, mund të përjashtohen nga testimi i aftësive teorike profesionale për disiplinat e mbuluara nga këto provime ose diploma.

10. Përjashtohen nga kryerja e praktikës profesionale dhe detyrohen të kryejnë vetëm testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, në disiplinat e legjislacionit fiskal, të shoqërive tregtare, sigurimeve shoqërore, të drejtën e punës dhe të drejtën civile, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kanë fituar titullin “Auditues ligjor” apo ekuivalentin e tij dhe janë të regjistruar për të ushtruar veprimtarinë si anëtarë të një organizate profesionale të audituesve ligjorë në një shtet tjetër, kur programi i përgatitjes së tyre vlerësohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë se është në pajtueshmëri, në masën jo më pak se 75 për qind, me programin e përgatitjes së audituesve ligjorë në Shqipëri.

11. Rregullat, procedurat dhe dokumentacioni që paraqitet për përjashtimin nga testet e provimit përfundimtar të aftësive profesionale miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me propozimin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.”.





## Neni 13

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

**Komiteti i regjistrimit**

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë krijon një komitet për zbatimin e procedurave të regjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit, vendas/e dhe të huaj/a.

2. Komiteti i regjistrimit përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga këshilli drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë për një periudhë katërvjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:

a) tre anëtarë, nga këshilli drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë;

b) dy anëtarë, respektivisht nga ministria përgjegjëse për financat dhe ministria përgjegjëse për ekonominë, me profil në fushën e ekonomisë dhe/ose jurisprudencës, si dhe me njohuri në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe financës.

3. Rregullat e hollësishme të funksionimit të komitetit të regjistrimit dhe procedurat e marrjes së vendimeve e të miratimit të regjistrimit hartohen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

4. Administrimi i procesit të regjistrimit bëhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë. Kostot e regjistrimit përballohen nga kandidatët që kërkojnë regjistrim, të cilët paguajnë një tarifë për regjistrim dhe çregjistrim, masa e së cilës përcaktohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, bazuar në kostot mesatare të regjistrimit. Tarifa e regjistrimit është e ndryshme për kërkesat për regjistrim si shoqëri auditimi dhe për ato si auditues ligjor.

5. Komiteti i regjistrimit mblidhet një herë në dy muaj, në javën e parë të muajit pasardhës.”

## Neni 14

Në nenin 25, pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“7. Organizata profesionale e audituesve ligjorë propozon për miratim, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, rregullat e kualifikimit të vijueshëm, të shoqëruara me sanksione, të cilat nisin me gjobë dhe përfundojnë me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në tre vjet, Faqe | 4660

për mosplotësimin e kërkesës së edukimit të vazhdueshëm.

8. Regjistrimi i audituesve ligjorë për të ushtruar profesionin është i përvitshëm. Mospërmbyshja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm është kusht për mosregjistrimin e audituesve ligjorë në listën e publikueshme për të gjithë vitin pasardhës.”

## Neni 15

Në nenin 26, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë publikon, në një aneks të veçantë të regjistrimit publik të audituesve ligjorë, të gjithë invididët e parashikuar në pikën 1, shkronja “e”, të këtij neni. Këta invidivë mund ta ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor vetëm nëse janë të punësuar ose të angazhuar në një shoqëri auditimi, të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë, që ka jo më pak se dy ortakë angazhimi dhe nën përgjegjësinë e kësaj të fundit.”

## Neni 16

Në nenin 32, pika 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese.”

## Neni 17

Në nenin 33 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Audituesi ligjor dhe shoqëria e auditimit, krahas auditimit ligjor, mund të kryejë edhe shërbimet e kontabilitetit, shërbimet e rishikimit e të dhënies së sigurisë ose shërbime të tjera, sipas përcaktimeve të bëra për to në standardet dhe deklaratat e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB), kur ato janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në të gjitha këto raste duhet të zbatohen dispozitat e këtij ligji për ruajtjen e pavarësisë dhe shmangien e konfliktit të interesit.”

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Tarifa e auditimit ligjor nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të



kryerjes së shërbimeve të tjera për njësinë ekonomike të audituar dhe nuk mund të jetë bazuar në ndonjë formë tjetër kushtëzimi.”.

## Neni 18

Në nenin 34, pika 3, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton rregullat për transferimin e informacionit, në rastet e zëvendësimit të audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese, pa përfunduar angazhimi i auditimit ligjor.”.

## Neni 19

Në nenin 38 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) kontrollin e cilësisë që organizohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund të delegojë kryerjen e kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike që nuk janë me interes publik, tek organizata profesionale e audituesve ligjorë. Organizata profesionale e audituesve ligjorë duhet të përmbushë këto kritere:

i) të demonstrojë që ka kapacitetet e duhura për të kryer këtë detyrë;

ii) të shqyrtojë çështjen e konfliktit të interesit para çdo kontrolli cilësie.

Bordi mbikëqyr këtë proces dhe revokon delegimin, kur e vlerëson të nevojshme.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Personat që realizojnë kontrollin e cilësisë brenda shoqërisë së auditimit duhet të jenë auditues ligjorë.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë, që kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nëpërmjet delegimit, organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë apo shoqëritë e auditimit, të cilat kontrollohen.”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Bordi miraton rregulla të hollësishme për organizimin e kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike jo me interes publik.”.

5. Pas pikës 5 shtohen pikat 6 e 7 me këtë përmbajtje:

“6. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton metodologjinë e kontrollit të cilësisë për strukturën mbështetëse.

7. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, që kryejnë auditime ligjore të njësive ekonomike me interes publik, si dhe të njësive ekonomike që nuk janë me interes publik, janë objekt i kontrollit të cilësisë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike apo nga organizata profesionale e audituesve ligjorë në rastet kur kryerja e kontrollit të cilësisë i delegohet kësaj të fundit.”.

## Neni 20

Në nenin 39 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kontrolli i cilësisë kryhet në bazë të një analize risku, të paktën një herë në çdo tre vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë ekonomike me interes publik, dhe një herë në çdo gjashtë vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë e tjera ekonomike. Për audituesit ligjorë, me jo më shumë se pesë vjet përvojë pune në profesion, ky kontroll kryhet, të paktën, një herë në dy vjet, derisa arrihet eksperiencia e kërkuar.”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Organizata profesionale e audituesve ligjorë raporton çdo vit, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, për rezultatet e sistemit të kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike që nuk janë me interes publik, në rastet kur ia ka deleguar bordi. Rezultatet e përgjithshme të sistemit të kontrollit të cilësisë publikohen çdo vit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Rekomandimet e dhëna në përfundim të procesit të kontrollit të cilësisë duhet të ndiqen për t’u zbatuar nga audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, brenda një periudhe kohe të arsyeshme.”.

## Neni 21

Në nenin 41, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;



ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

#### Neni 22

Në nenin 42, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shoqëritë tregtare, të parashikuara në shkronjat “a” e “b”, të nenit 41, të këtij ligji, janë të detyruara të emërojnë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të tyre, të paktën, një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar jo më pak se dy auditues ligjorë; ose dy auditues ligjorë, persona fizikë; një auditues ligjor person fizik dhe një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar, të paktën, një auditues ligjor; apo dy shoqëri auditimi, që kanë të regjistruar, përkatësisht, vetëm një auditues ligjor.”

#### Neni 23

Pas nenit 43 shtohet neni 43/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 43/1

#### Raporti i auditimit

Kur shoqëria e auditimit kryen auditim ligjor, raporti i auditimit do të nënshkruhet dhe datohet nga, të paktën, njëri prej audituesve ligjorë që kryejnë auditimin ligjor në emër të shoqërisë audituese.”

#### Neni 24

Titulli i kreut VI ndryshohet si më poshtë:

“Dispozita të posaçme për auditimin ligjor të njësisve ekonomike me interes publik”.

#### Neni 25

Në nenin 45 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, fjalët “shoqërive të listuara në bursë, bankave dhe shoqërive të sigurimeve” zëvendësohen me fjalët “njësive ekonomike me interes publik”.

2. Në shkronjën “dh”, fjalët “shoqërive të listuara në bursë, bankave dhe shoqërive të sigurimeve” zëvendësohen me fjalët “njësive ekonomike me interes publik”.

3. Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) informacion në lidhje me bazat për shpërblimin e ortakëve të angazhimit.”.

#### Neni 26

Në nenin 46, pika 1, fjalët “Shoqëritë e listuara në bursë, bankat dhe shoqëritë e sigurimeve” zëvendësohen me fjalët “Njësitë ekonomike me interes publik”.

#### Neni 27

Në nenin 47 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët “shoqërie të listuar në bursë, banke apo shoqërie sigurimesh” zëvendësohen me fjalët “njësie ekonomike me interes publik”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Audituesi ligjor ose ortaku kryesor, që kryen auditimin ligjor në emër të një shoqërie auditimi, nuk ka të drejtë të pranojë ose të kryejë funksione të rëndësishme drejtimi në njësinë ekonomike të audituar pa kaluar një periudhë kohe prej, të paktën, një viti, ose, në rastin e auditimit të njësisve ekonomike me interes publik, të paktën, 2 vitesh, nga koha kur ka dhënë dorëheqjen si auditues ligjor ose ortak kryesor nga angazhimi i auditimit.”.

#### Neni 28

Në nenin 50, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Për të fituar titullin “Kontabilist i miratuar”, kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 49, të këtij ligji, i nënshtrohen provimit përfundimtar të aftësive profesionale vetëm për testet, të cilave u nënshtrohen edhe audituesit ligjorë, të parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të nenit 18, të këtij ligji.”.

#### Neni 29

Neni 55 riformulohet si më poshtë:

#### Neni 55

#### Shkeljet dhe masat disiplinore

1. Masat disiplinore për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit janë:

a) vërejtje me shënim në regjistrin publik;

b) gjobë;

c) pezullim i përkohshëm, për një kohë jo më shumë se pesë vjet;



ç) fshirje e përhershme nga regjistri publik, e cila përmban ndalimin, përgjithmonë, të ushtrimit të profesionit.

2. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Dënimi me gjobë në masën nga 50 000–100 000 lekë jepet në rastet kur audituesi ligjor ka bërë kërkesë për çregjistrim, me arsyen e fillimit të një veprimtarie të re, dhe e ka nisur veprimtarinë e re, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, përpara marrjes së vendimit nga komiteti i regjistrimit, sipas afateve të parashikuara në rregulloren e miratuar, sipas nenit 29 të këtij ligji.

4. Dënimi me gjobë në masën 50 000–200 000 lekë jepet në rast se, në përfundim të procesit të kontrollit të cilësisë, rezulton që puna audituese nuk është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me kërkesat e këtij ligji e akteve nënligjore.

5. Dënimi me gjobë në masën 50 000–150 000 lekë jepet në rastin e mosdhënies së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar nga autoritetet përgjegjëse, në kuadër të procesit të kontrollit të cilësisë.

6. Dënimi me gjobë në masën 100 000–500 000 lekë jepet në rast të mosndjekjes së rregullave dhe procedurave të auditimit, që kanë sjellë dhënien e një opinioni të mangët ose të gabuar për pasqyrat financiare subjekt auditimi.

7. Dënimi me gjobë në masën 50 000–150 000 lekë jepet në rast se nuk respektohen kërkesat e parashikuara nga neni 34, i këtij ligji, për mbrojtjen e konfidencialitetit.

8. Dënimi me gjobë në masën 50 000–100 000 lekë jepet në rastin kur informacionet vjetore statutores, të paraqitura pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, janë të pasakta.

9. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, jepet në rastet kur:

a) ka përsëritje të shkeljes, më shumë se dy herë, të pikave 4, 5, 7 e 8 të këtij neni;

b) audituesi ligjor, gjatë funksioneve të tij, kryen edhe funksionin e të punësuarit apo funksione të tjera, që janë në papajtueshmëri me profesionin e audituesit ligjor;

c) marrja përsipër e misionit të auditimit është bërë pa respektuar procedurat e emërimit të tij, të

parashikuara nga dispozitat e këtij ligji, si dhe nga rregullat e auditimit apo nga statuti;

ç) vërtetohet se raporti i auditimit nuk bazohet në dokumentacionin që përmban dosja e auditimit;

d) nga rezultatet e kontrollit të cilësisë rezulton vlerësimi “dobët”;

dh) ka mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet deklaramit vjetor të kohës, sipas angazhimeve të kryera, dhe kohës në dispozicion të llogarit, duke mbajtur parasysh bashkëpunëtorët dhe të punësuarit e deklaruar, si dhe mosdeklarimin e bashkëpunëtorëve e të punësuarve.

10. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, jepet në rastet kur:

a) shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare bazohen, në një masë të madhe, te rezultatet e rishikimeve periodike të pasqyrave financiare të përmbledhura dhe të auditimit të brendshëm, që janë kryer nga vetë audituesi ligjor apo shoqëria audituese;

b) audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit përfshihen në shërbime të dhënies së sigurisë për pasqyrat financiare, që përgatiten për qëllime të klientit, kur verifikohet se këto të fundit janë informale dhe të ndryshme nga pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme;

c) shkelja e përcaktuar në pikën 6 dhe shkeljet e përcaktuara në pikën 9, të këtij neni, përsëriten më shumë se dy herë.

11. Pezullimi i përkohshëm shoqërohet me ndëshkimin plotësues të moszgjedhjes në organet drejtuese të organizatës profesionale ose në organe të tjera, të parashikuara në këtë ligj. Pezullimi mund të jetë i përgjithshëm ose i kufizuar, në një apo disa kategori shoqërishe e shërbimesh.

12. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton rregulloren për procedurat disiplinore, e cila detajon procedurat për fillimin dhe shqyrtimin e shkeljeve disiplinore, përcaktimin e masës së gjobës dhe rastet e ngarkimit të audituesve ligjorë ose shoqërive të auditimit me detyrimin e mbulimit të shpenzimeve të procedurës disiplinore.

Neni 30

Neni 56 shfuqizohet.

Neni 31

Pas nenit 57 shtohen nenet 57/1 dhe 57/2 me këtë përmbajtje:



“Neni 57/1

### **E drejta e ankimit**

Kundër vendimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit mund të bëjë ankim në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 ditëve nga data e njofimit të vendimit.

Neni 57/2

### **Shlyerja e gjobave**

Në rastin e masës disiplinore me gjobë, audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit duhet të shlyejë, brenda 2 muajve, masën e gjobës. Në të kundërt, zbatohet masa disiplinore e pezullimit të përkohshëm, deri në çastin e shlyerjes së saj.”

Neni 32

Kudo, në përmbajtjen e këtij ligji, bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimi “Autoriteti i Certifikimit” zëvendësohet me emërtimin “Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale”.

2. Emërtimi “autoritet i regjistrimit” zëvendësohet me emërtimin “komiteti i regjistrimit”.

3. Termi “certifikim” zëvendësohet me termin “testim”.

4. Termat “ekspert kontabël i regjistruar”, “ekspert kontabël” dhe “auditues i jashtëm” zëvendësohen me termin “auditues ligjor”.

Sa herë që në ligjet e posaçme referohet në termat “ekspert kontabël i autorizuar”, “ekspert kontabël i regjistruar”, “ekspert kontabël” ose “auditues i jashtëm”, referenca vlerësohet si e bërë në termin “auditues ligjor”.

5. Fjala “stazh” zëvendësohet me fjalët “praktikë profesionale”.

Neni 33

### **Dispozita kalimtare**

1. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, të zgjedhur në këtë funksion para hyrjes në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e bordit të ri.

2. Ministri i Financave miraton anëtarët e rinj të bordit brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Struktura mbështetëse e bordit krijohet brenda një muaji, nga konfigurimi i bordit të ri. Deri në krijimin dhe fillimin e funksionimit të

strukturës mbështetëse, funksionet e saj kryhen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.

4. Kryetari dhe anëtarët e autoritetit të regjistrimit, të zgjedhur në këtë funksion para hyrjes në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e komitetit të regjistrimit.

5. Anëtarët e rinj të komitetit të regjistrimit emërohen brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

6. Kryetari dhe anëtarët e zgjedhur të Autoritetit të Certifikimit, të emëruar në këtë funksion para hyrjes në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të Komisionit të Provimit të Aftësive Profesionale.

7. Anëtarët e rinj të Komisionit të Provimit të Aftësive Profesionale emërohen brenda dy muajve nga konstituimi i Bordit të ri të Mbikëqyrjes Publike.

8. Deri në ngritjen e strukturave të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, kontrolli i cilësisë do të vazhdojë të kryhet sipas sistemit ekzistues, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

9. Stazhierët, të cilët e kanë filluar praktikën profesionale përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vijojnë me procedurat e praktikës profesionale, të parashikuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

10. Kufizimet e ripërtëritjes së mandateve të organeve të drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë llogariten që nga koha kur organi përkatës është ngritur dhe ka funksionuar për herë të parë. Anëtarët e organeve të zgjedhura të organizatës profesionale të audituesve ligjorë përfundojnë mandatin, sipas afateve të parashikuara në këtë ligj.

11. Për të siguruar vazhdimësinë në përbërjen dhe punën e Këshillit Drejtues të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, pas përfundimit të mandatit aktual, tre prej anëtarëve të Këshillit Drejtues, të përcaktuar me short, u shtyhet mandati për një periudhë 2-vjeçare.

Neni 34

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2, pika 23, dhe 4, pika 9, të ligjit.

2. Ngarkohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4/1, pika 3; 17, pikat 5 e 6; 18, pika 11; 19, pika 3; 25,



pika 7; 34, pika 3; 38, pikat 5 e 6; dhe 55, pika 12, të ligjit.

3. Ngarkohet organizata profesionale e audituesve ligjorë që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 12, të ligjit.

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ndryshimet e parashikuara në nenin 21, të këtij ligji, zbatohen për herë të parë mbi raportimin financiar të vitit 2016.

Miraturar në datën 28.4.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9599, datë 16.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 48/2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA**  
**NË LIGJIN NR. 9385, DATË 4.5.2005,**  
**“PËR PYJET DHE SHËRBIMIN**  
**PYJOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në të gjithë ligjin:

- emërtimi “Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me emërtimin “ministri përgjegjës për pyjet”;

- emërtimi “Ministria e Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me emërtimin “ministria përgjegjëse për pyjet”;

- togfjalëshi “njësi e qeverisjes vendore” zëvendësohet me fjalën “bashki”;

- emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor” zëvendësohet me togfjalëshin

“drejtoria përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet”;

- emërtimi “drejtori rajonale e shërbimit pyjor” zëvendësohet me emërtimin “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”.

Neni 2

Në nenin 1, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Nuk janë objekt i këtij ligji zonat e mbrojtura, fauna e egër, si dhe bimët mjekësore eterovajore e tanifere natyrore, të cilat rregullohen sipas legjislacionit të përkatës në fuqi.”.

Neni 3

Në nenin 2, pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. “Inspektor i Policisë Pyjore” është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur, i pajisur me kartë identifikimi, që ka atributet e njohura me këtë ligj, i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet, i cili ka për detyrë zbatimin e ligjit, administrimin, mbrojtjen, parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarive kriminale dhe mbikëqyrjen e fondit pyjor kombëtar.”.

Neni 4

Në nenin 4, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Ministria, në bashkëpunim me bashkitë, harton dhe përpunon programin e zhvillimit të sektorit të pyjeve, i cili miratohet me urdhër të ministrit.”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Shërbimi pyjor organizohet si më poshtë:

a) ministria përgjegjëse për pyjet, si organ qendror politikëbërës;

b) strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki;

c) Policia Pyjore, pjesë e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet.

3. Strukturat dhe organikat e shërbimit pyjor në ministrinë përgjegjëse për pyjet dhe Policisë Pyjore miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:



3/1. Bashkia ngre strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullësor brenda kufijve territorialë administrativë, me personel inxhinierio-teknik me arsim pyjor. Raporti midis një nëpunësi të bashkisë me sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullësor që ai mbulon është jo më pak se një nëpunës për:

- a) 750–1 000 ha, për pyjet e larta;
- b) 1 500–2 500 ha, për pyjet e ulëta dhe shkurret;
- c) 4 000–6 000 ha, për kullota dhe livadhe.”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

#### **Strukturat e shërbimit pyjor**

1. Ministria përgjegjëse për pyjet është organi më i lartë politikëbërës në fushën e pyjeve dhe përgjigjet për hartimin e legjislacionit përkatës të pyjeve, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor kombëtar.

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkive janë organi administrativ i shërbimit pyjor dhe përgjigjen për sigurimin e mbrojtjes, për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullësor brenda territorit administrativ të bashkisë.

3. Punonjësit e shërbimit pyjor pajisen me uniformë (me shenja dalluese), me dokument identifikimi, me armatim, me tabela të ndalimit të automjeteve dhe me mjete të tjera teknike, të domosdoshme e të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve e të mjeteve të tjera caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

#### **Ministria përgjegjëse për pyjet**

1. Ministria përgjegjëse për pyjet është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, si dhe miratimin e planeve të menaxhimit për fondin pyjor kombëtar.

2. Ministria përgjegjëse për pyjet:

2.1. Është organ i specializuar politikëbërës, me attribute teknike, menaxhuese, kontrolluese e këshillimore.

2.2. Siguron/ofron mbështetje teknike në fondin pyjor kombëtar dhe ka këto detyra:

a) qeverisjen politike të pyjeve dhe të tokave pyjore;

b) mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e pyjeve publike dhe private;

c) ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor kombëtar;

ç) mbajtjen dhe administrimin e të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit pyjor, të kadastrës pyjore, të projekteve, të financës, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, të të dhënave bazë për tërësinë e fondit pyjor e kullësor dhe të tokave pyjore, si dhe të punimeve e përgjithësimeve statistikore;

d) ndjekjen e zbatimit të planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit të pyjeve, të kullotave, të florës e të faunës së egër, si dhe të shmangies së sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve;

dh) ndjekjen, bashkëpunimin, harmonizimin dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore në pyje e kullota;

e) ndjekjen e përpunimit të metodologjive për mbledhjen e të dhënave të zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, përpunimin e këtyre të dhënave dhe përgatitjen e informacionit për publikun;

ë) sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;

f) kontrollin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota, pavarësisht nga burimi i financimit.”.

Neni 8

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

#### **Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki**

1. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki është organ i specializuar i këtij shërbimi në nivel vendor, me attribute teknike, menaxhuese e këshillimore, në përbërje të bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki kryen shërbime teknike e publike në fondin pyjor vendor dhe ka këto detyra:



a) qeverisjen tërësore të pyjeve dhe të tokave pyjore;

b) mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e pyjeve publike dhe private;

c) ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor;

ç) mbajtjen dhe administrimin e të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit të fondit pyjor privat brenda njësisë administrative të bashkisë;

d) të mbajë të dhëna të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në pyjet e kullotat e bashkisë;

dh) përgatitjen e projekteve për investimet në pyje e kullota;

e) drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;

ë) ndjekjen, bashkëpunimin, harmonizimin dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore në pyje e kullota;

f) mbikëqyrjen e zhvillimit të florës e faunës së egër dhe propozimin e metodave për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik;

g) sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;

gj) organizimin e trajnimeve dhe të shërbimeve këshillimore për pronarët privatë;

h) kontrollin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota, pavarësisht nga burimi i financimit;

i) mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor bashkiak;

j) hartimin dhe zbatimin e një programi për trajnimin e punonjësve të shërbimit pyjor dhe aftësimin e tyre profesional;

k) mbështetjen e zhvillimit të agropylltarisë në bashki.”

Neni 9

Në nenin 15 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Fondi pyjor publik ndahet në:

a) pyje e toka pyjore në pronësi të bashkisë brenda territorit administrativ ku ato ndodhen;

b) zona të mbrojtura, në pronësi të ministrisë përgjegjëse për pyjet.”

Neni 10

Në nenin 16, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Fondi pyjor kombëtar dhe infrastruktura integrale e tij regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë referuar pronësisë së përcaktuar në pikën 3 të nenit 15 të ligjit.”

Neni 11

Në nenin 19, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit pyjor bashkiak bëhet në bazë të kontratave, të nënshkruara nga kryetari i bashkisë. Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton, për sipërfaqen e fondit pyjor, objekt kontrate, studime urbanistike. Rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar caktohen me udhëzim të ministrit.”

Neni 12

Në nenin 26 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 6 shfuqizohet.

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki çdo vit hartojnë dhe dërgojnë për miratim në ministrinë përgjegjëse për pyjet planin e shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore. Drejtoria përkatëse e ministrisë përgjegjëse për pyjet kontrollon zbatimin e këtij plani.”

Neni 13

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

### **Ndarja e burimeve financiare**

Burimet financiare, të krijuara sipas nenit 32, të ligjit, derdhen 100 për qind në buxhetin e bashkisë.”

Neni 14

Neni 33 shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 34, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave është struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.”





Neni 16

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

**Vendimi për kundërvajtjet administrative  
dhe ankimi**

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative merret nga Policia Pyjore, në zbatim të legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndaj vendimit të dhënë, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, bëhet ankimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Procedura e ekzekutimit të vendimit të dënimit me gjobë bëhet në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 17

Neni 40/2 shfuqizohet.

Neni 18

**Dispozitë kalimtare**

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për pyjet, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton transferimin e pyjeve në pronësi të bashkive.

Neni 19

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.5.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9600, datë 16.5.2016,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**

**Nr. 50/2016**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË  
KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN  
EKONOMIK ARAB PËR FINANCIMIN E  
PROJEKTIT “REHABILITIMI I RRUGËS  
SË LUMIT TË VLORËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

Faqe | 4668

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.5.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9601, datë 16.5.2016,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

ORIGINALI: ARABISHT

HUAJA NR. ....

**MARRËVESHJE HUAJE**

**PROJEKTI I REHABILITIMIT TË RRUGËS  
SË LUMIT TË VLORËS  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE FONDIT TË KUVAJTIT PËR  
ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB**

DATË: ... . . . . .2015

Marrëveshje, datë ----- ndërmjet Republikës së Shqipërisë (më poshtë i referuar si Huamarrësi) dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (në vijim i referuar si Fondi).

Kur Huamarrësi ka kërkuar Fondin për të ndihmuar në financimin e Projektit të Rehabilitimit të Rrugës së lumit të Vlorës të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshje (në vijim i referuar si Projekti), duke siguruar një kredi (në tekstin në vijim “Kredia”);

Kur projekti do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Huamarrësit (në vijim i referuar si “FSHZH”, nëpërmjet stafit të tij aktual dhe personelit, ndërsa operimi dhe mirëmbajtja e projektit do të ndërmerren nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar (në vijim i referuar si “ARSH”);



Kur Huamarrësi ka marrë përsipër të sigurojë të gjitha shumat, përveç kredisë, qoftë në monedhë të huaj apo monedhën vendase, të cilat janë të nevojshme për ekzekutimin e Projektit, si dhe shuma shtesë qoftë në monedhë të huaj apo monedhën vendase, si rezultat i ndonjë rritjeje në vlerësimet e kostos së Projektit;

Kur qëllimi i Fondit është të asistojë vendet arabe dhe vendet e tjera në zhvillim për zhvillimin e ekonomive të tyre dhe për t'i pajisur ato me kredi të nevojshme për zbatimin e projekteve dhe programeve të tyre të zhvillimit; dhe

Kur Fondi është i bindur për rëndësinë dhe përfitimet e Projektit për të kontribuar në zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit; dhe

Kur Fondi ka rënë dakord në bazë, ndër të tjera, për sa më sipër, për të siguruar kredi për Huamarrësin, sipas termave dhe kushteve të parashtruar në këtë Marrëveshje.

Si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

#### Neni I

### **Kredia; interesi dhe tarifa të tjera; shlyerja; vendi i pagesës**

Seksioni 1.01. Fondi bie dakord t'i japë Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose të përmendur këtu, një shumë ekuivalente me dymbëdhjetë milionë dinarë kuvajtianë (K.D. 12.000.000/-).

Seksioni 1.02. Huamarrësi do të paguajë interes në normën prej dy për qind (2.0%) në vit mbi shumën e principalit të Kredisë të tërhequr dhe të papaguar herë pas here. Interesi do të akumulohet nga datat përkatëse në të cilat do të tërhiqen shumat.

Seksioni 1.03. Një pagesë shtesë prej gjysmë për qind e një përqindëshit (1/2 e 1%) në vit mbi shumat e tërhequra nga huaja dhe të papaguara herë pas here do të paguhet për të përmbushur shpenzimet administrative dhe shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.04. Në rast se Fondi, në pajtim me seksionin 3.02 të kësaj Marrëveshjeje, hyn në një angazhim të veçantë të parevokueshëm me kërkesë të Huamarrësit, një pagesë për një angazhim të tillë të veçantë do të paguhet nga Huamarrësi në normën e një gjysmë për qind të një përqindëshit (1/2 e 1%) në vit mbi shumën e principalit të çdo angazhimi të tillë të veçantë të papaguar herë pas here.

Seksioni 1.05. Interesi dhe detyrimet e tjera do të llogariten mbi bazën e një viti 360-ditor nga dymbëdhjetë muaj 30-ditorë për çdo periudhë më pak se gjysma e plotë e një viti.

Seksioni 1.06. Huamarrësi do të shlyejë principalin e huas në pajtim me dispozitat për amortizimin e huas të përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.07. Interesi dhe detyrimet e tjera do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj, më 1 maj dhe 1 nëntor, çdo vit ose një ditë para, nëse një datë e tillë bie në ditët e festave zyrtare.

Seksioni 1.08. Huamarrësi ka të drejtë, kundrejt pagesës së të gjithë interesit të llogaritur dhe të gjitha tarifat e tjera dhe me jo më pak se një njoftim 45-ditor për Fondin, për ta shlyer para maturimit: a) të gjithë shumën e principalit të huas të papaguar në atë kohë; ose b) të gjithë shumën e principalit të një ose më shumë maturimeve, me kusht që pas një parapagimi të tillë, nuk do të jetë e papaguar ndonjë pjesë e huas që maturohet pasi pjesa të jetë papaguar.

Seksioni 1.09. Principali dhe interesi dhe tarifat e tjera mbi Kredinë do të paguhet në Kuvajt ose në vende të tilla të tjera që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme

#### Neni II

### **Dispozitat e valutës**

Seksioni 2.01. Të gjitha llogaritë e transakcioneve financiare të kryera në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha shumat që bëhen të pagueshme sipas saj do të jenë të pagueshme në dinarë kuvajtianë.

Seksioni 2.02. Fondi do të blejë, me kërkesë të dhe duke vepruar si agjent për Huamarrësin, monedha të tilla që mund të kërkohen për pagesën e kostos së mallrave që do të financohen nga huaja sipas kësaj Marrëveshjeje ose për rimbursimin e kostos së tillë në monedhën në të cilën është kryer në fakt. Shuma, e cila do të konsiderohet se është tërhequr nga huaja në çdo rast të tillë, do të jetë e barabartë me shumën në dinarë kuvajtianë, të nevojshme për blerjen e shumës përkatëse të valutës së huaj.

Seksioni 2.03. Kur shlyerja e principalit ose pagesa e interesit dhe detyrimeve të tjera mbi huan është duke u kryer, Fondi me kërkesë të dhe duke vepruar si agjent për Huamarrësin, mund të blejë shumën e dinarëve kuvajtianë të kërkuar për



shlyerjen ose pagesën e tillë, sipas rastit, kundrejt pagesës nga Huamarrësi të shumës së kërkuar për blerje të tillë në monedhën ose monedhat, siç mund të jetë e pranueshme herë pas here për Fondin.

Çdo pagesë për Fondin e kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet se është kryer përveç kur dhe deri në masën që dinarët kuvajti janë të jenë marrë në fakt nga Fondi.

Seksioni 2.04. Kurdoherë që do të jetë e nevojshme për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje për të përcaktuar vlerën e një monedhe kundrejt një tjetre, vlera të tilla do të përcaktohen në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.

### Neni III

#### Tërheqja dhe përdorimi i fondeve të Huas

Seksioni 3.01. Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga huaja shumat e shpenzuara ose që do të shpenzohen për Projektin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Përveç rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, asnjë shumë nuk do të tërhiqet nga huaja për llogari të shpenzimeve brenda kategorive të Projektit të përshkruara në shtojcën 2 të ndodhura para 1 janarit 2016 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me kërkesë të Huamarrësit dhe sipas afateve dhe kushteve të tilla, siç do të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, Fondi mund të hyjë në angazhime të veçanta të pakthyeshme me shkrim për të paguar shumat për Huamarrësin ose të tjera në lidhje me koston e mallrave që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht çdo anulimi të mëvonshëm të huas ose pezullimin e së drejtës së Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja.

Seksioni 3.03. Kur Huamarrësi do të dëshirojë të tërheqë ndonjë shumë nga huaja ose t'i kërkojë Fondit për të hyrë në një angazhim të veçantë të pakthyeshëm në pajtim me seksionin 3.02, Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do t'i paraqesë Fondit një kërkesë me shkrim në formë të tillë dhe që përmban deklarata të tilla, marrëveshje dhe dokumente të tjera që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Aplikimet për tërheqje, me dokumentacionin e nevojshëm në vijim të këtij seksioni, me kusht që përveç siç Huamarrësi dhe Fondi do të bien dakord ndryshe, do të kryhen nëpërmjet FSHZH-së menjëherë, në lidhje me shpenzimet për Projektin.

Seksioni 3.04. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do t'i japë Fondit dokumente dhe prova të tjera në mbështetje të kërkesës për tërheqje, siç Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, qoftë para ose pasi Fondi do të ketë lejuar ndonjë tërheqje të kërkuar në aplikim.

Seksioni 3.05. Çdo kërkesë për tërheqje dhe dokumentet shoqëruese dhe prova të tjera duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të bindur Fondin që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga huaja shumën e zbatuar për të dhe që shumat për t'u tërhequr nga huaja duhet të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

Seksioni 3.06. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të përdorë të ardhurat e Huas, ekskluzivisht për financimin e kostove të arsyeshme të mallrave të nevojshme për kryerjen e Projektit, të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Mallrat specifike që do të financohen nga të ardhurat e huas dhe metodat dhe procedurat për prokurimin e këtyre mallrave do të përcaktohen si në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe shtojcën e saj dhe, pa cenuar asgjë të shprehur në shtojcën 3 të përmendur, kjo shtojcë do të jetë objekt i modifikimit me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, sipas nevojave të Projektit dhe kërkesave të zbatimit të tij.

Seksioni 3.07. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të marrë masa që të gjitha mallrat e financuara nga shumat e huas të përdoren ekskluzivisht për realizimin e Projektit.

Seksioni 3.08. Paga nga Fondi i shumave, të cilën Huamarrësi ka të drejtë ta tërheqë nga huaja, do të kryhet ndaj ose me porosi të Huamarrësit.

Seksioni 3.09. E drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja do të përfundojë më 31 dhjetor 2020 ose në një datë tjetër, siç mund të bihet herë pas here dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

### Neni IV

#### Marrëveshje të veçanta

Seksioni 4.01. Huamarrësi do të ndërmarrë masa për të bërë fondet e huas të disponueshme për FSHZH-në nëpërmjet një marrëveshjeje partneriteti ndërmjet Huamarrësit dhe FZSHH-së në formë granti të pranueshëm për Fondin.

Seksioni 4.02. Huamarrësi do të bëjë ose do të marrë masa që të vihen në dispozicion menjëherë,



sipas nevojës, të gjitha shumat e tjera që do të kërkohen, përveç huas për realizimin e Projektit, të gjitha shumat e tilla të jenë në dispozicion në kushte në përputhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja t'i japë Fondit, menjëherë pas përgatitjes së tyre, studimet dhe planet dhe specifikimet për Projektin, skicat e ekzekutimit të tij dhe çdo modifikim material të bërë më pas atyre, në detaje të tilla që Fondi mund të kërkojë herë pas here.

Seksioni 4.04. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të realizojë Projektin me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me praktikën e duhura inxhinierike, administrative dhe financiare.

Seksioni 4.05. Në kryerjen e Projektit, Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të punësojë konsulentë inxhinierikë të pranueshëm për dhe sipas afateve dhe kushteve të kënaqshme për Fondin.

Seksioni 4.06. Dhënia e kontratave për ekzekutimin e Projektit, të cilat duhet të financohen nga huaja dhe çdo ndryshim në to, do të jetë objekt i miratimit të Fondit, si dhe do të kryhet në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit të Fondit, përveç metodave të veçanta dhe procedurave të përcaktuara në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe duke pasur parasysh kërkesat e shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.07. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të mbajë të dhënat e duhura për të identifikuar mallrat e financuara nga fondet e Huas, të bëjë të dukshme përdorimin e tyre në Projekt, për të regjistruar progresin e Projektit (duke përfshirë shpenzimet e tij) dhe të reflektojë në përputhje me praktikën e qëndrueshme të kontabilitetit të mbajtura në vazhdimësi të operacioneve dhe gjendjen financiare të FSHZH-së. Huamarrësi nëpërmjet FSHZH-së do t'i japë më tej të gjithë mundësinë e arsyeshme përfaqësuesit të akredituar të Fondit për të kryer vizita për qëllime që lidhen me huan dhe për të inspektuar Projektin, mallrat dhe çdo të dhënë dhe dokumente përkatëse dhe do t'i japë Fondit të gjithë informacionin e tillë që Fondi mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimin e të ardhurave të Huas, Projektin, mallrat dhe operacionet dhe gjendjen financiare të FSHZH-së në lidhje me Projektin.

Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja t'i japë Fondit çdo tre muaj, që nga data e fillimit të zbatimit të Projektit, raporte mbi përparimin e zbatimit.

Seksioni 4.08. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të sigurojë me ofruesit përgjegjës të gjitha furnizimet dhe pajisjet e financuara nga të ardhurat e Huas. Një sigurim i tillë do të mbulojë incidentet detare, të tilla si transiti dhe rreziqe të tjera për blerjen dhe importimin e furnizimeve dhe pajisjeve në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimin e tyre në vendin e Projektit dhe do të jetë për shumën të tilla siç duhet të jetë në përputhje me praktikën e qëndrueshme tregtare. Sigurimi i tillë do të jetë i pagueshëm në monedhën në të cilën kostoja e mallrave të siguruara do të paguhet aty ose në monedhë lirisht të konvertueshme.

Huamarrësi do të marrë masa që FZSHH-ja të marrë dhe të ruajë, me ofruesit përgjegjës, sigurimin kundër rreziqeve të lidhura me zbatimin e Projektit, në shumën të tilla që do të jenë në pajtim me praktikën e qëndrueshme tregtare.

Seksioni 4.09. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të marrë në kohën e duhur të gjitha veprimet e nevojshme për blerjen e tokës ose të drejtave të tokës të nevojshme për zbatimin e Projektit.

Seksioni 4.10. Huamarrësi dhe Fondi do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që të realizohen qëllimet e Huas. Për këtë qëllim, secila palë do t'i japë informacione palës tjetër siç mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme në lidhje me statusin e përgjithshëm të Huas.

Huamarrësi dhe Fondi do të shkëmbejnë herë pas here mendime nëpërmjet përfaqësuesve të tyre për çështjet që lidhen me qëllimet e huas dhe mirëmbajtjen e shërbimit të saj. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të informojë menjëherë Fondin për çdo kusht që ndërhyrë ose rrezikon të ndërhyjë në arritjen e qëllimeve të huas (duke përfshirë edhe rritje të konsiderueshme në koston e Projektit) apo mirëmbajtjen e shërbimit të tij.

Pas përfundimit të Projektit, Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja t'i paraqesë Fondit një Raport Përfundimtar të Projektit jo më vonë se gjashtë muaj pas datës në të cilën e drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja përfundon sipas seksionit 3.09 të kësaj Marrëveshjeje. Raporti i tillë do të jetë në gjuhën angleze dhe përmban një krahasim të shpenzimeve dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të Projektit me



shpenzimet dhe kohëzgjatjen e saj të vlerësuar fillimisht. Raporti do të shpjegojë arsyet për ndonjë rritje të ndjeshme të kostos së vlerësuar fillimisht për Projektin apo vonesë në ekzekutimin e tij dhe të tregojë problemet dhe pengesat e hasura dhe masat e marra për trajtimin e tyre.

Seksioni 4.11. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të marrë ose të bëjë që të merren të gjitha veprimet e nevojshme nga ana e tij për të ekzekutuar Projektin dhe nuk do të marrë ose nuk të lejojë që të merret ndonjë veprim që do të parandalonte ose ndërhynte në ekzekutimin ose funksionimin e Projektit ose përmbushjen e ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 4.12. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, do të vazhdojë të mbajë në mënyrë të mjaftueshme dhe të riparojë ose të bëjë të mbahen në mënyrë të mjaftueshme dhe të riparohen rrugët dhe urat e saj në përputhje me standardet e duhura inxhinierike dhe duke i respektuar kërkesat financiare dhe ekonomike dhe duhet të ofrojë menjëherë kur është e nevojshme, fondet, lehtësirat, shërbimet dhe burimet e tjera të nevojshme për këtë qëllim, përfshirë shpërndarjen e mjaftueshme të buxhetit ndaj ARA-s.

Seksioni 4.13. Huamarrësi do të vazhdojë të garantojë që dimensionet dhe ngarkesat e aksit të automjeteve që përdorin rrugët e tij duhet të jenë në përputhje me standardet strukturore dhe gjeometrike të projektimit të këtyre rrugëve. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të vazhdojë të mbajë një sistem efikas të kontrollit të ngarkesës së aksit dhe të zbatojë rregullat e përshkruara të ngarkesës boshtore.

Seksioni 4.14. Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe për të siguruar që Projekti të realizohet dhe të veprohet në përputhje me praktikën ekologjike dhe mjedisore të përshtatshme për vendin dhe kushtet e tij, të marrë masat e nevojshme për të zbutur ndikimet negative që Projekti mund të ketë në mjedis.

Seksioni 4.15. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, do të marrë masa që ARSH-ja të veprojë dhe të mirëmbajë Projektin dhe të operojë dhe të mirëmbajë strukturat dhe vepra të tjera dhe objektet që nuk përfshihen në Projekt, por që janë të nevojshme për funksionimin e tij të duhur dhe efikas në përputhje me praktikën e duhura të inxhinierisë,

financiare dhe administrative.

Seksioni 4.16. Huamarrësi do të sigurojë që FSHZH-ja ose çdo organ pasues i pranueshëm për Fondin, të vazhdojë të funksionojë në çdo kohë sipas rregullave dhe rregulloreve dhe të ketë të drejta të tilla menaxhimi dhe administrimi që janë të nevojshme për funksionimin e duhur dhe efikas në realizimin e Projektit.

Huamarrësi, në frymën e bashkëpunimit pozitiv që mbizotëron midis dy palëve, duhet të informojë Fondin për çdo veprim të propozuar që do të ndikonte në natyrën apo përbërjen e FSHZH-së apo çdo organi pasues të pranueshëm për Fondin dhe do t'i japë Fondit të gjithë mundësinë e arsyeshme para marrjes së një veprimi të tillë, për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin në lidhje me to.

Seksioni 4.17. Është qëllimi i përbashkët i Huamarrësit dhe i Fondit që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të ketë përparësi mbi huan me anë të një barre të krijuar mbi asetet qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që përveç rasteve kur Fondi bie dakord ndryshe, nëse do të krijohet barrë mbi ndonjë aset të Huamarrësit, si garanci për një borxh të jashtëm, një barrë e tillë *ipso facto* do të jetë e barabartë dhe proporcionalisht do të sigurojë pagesën e principalit dhe interesit dhe detyrimet e tjera mbi huan dhe se në krijimin e një barre të tillë, një dispozite e shprehur do të bëhet për këtë qëllim; me kusht që dispozitat e mësipërme të këtij seksioni nuk duhet të zbatohen, për:

i) ndonjë barrë të krijuar mbi pronën, në kohën e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së pronës së tillë;

ii) ndonjë barrë mbi mallrat tregtare për të siguruar një borxh që maturohet jo më shumë se një vit pas datës në të cilën ka lindur fillimisht dhe që duhet të paguhet nga të ardhurat e shitjes së mallrave të tilla komerciale; ose

iii) ndonjë barrë që lind në rrjedhën e zakonshme të transaksioneve bankare dhe sigurimin e borxhit që maturohet jo më shumë se një vit pas datës së tij.

Termi “Asetet e Huamarrësit” siç përdoret në këtë nen përfshin asetet e Huamarrësit ose të ndonjë prej nënndarjeve të tij politike apo ndonjë subjekti në pronësi, apo të kontrolluar nga Huamarrësi ose nga ndonjë nënndarje e tillë politike, duke përfshirë edhe Bankën Qendrore të Huamarrësit ose ndonjë institucion tjetër që kryen



funksionet e një Banke Qendrore dhe termi “barrë” përfshin hipotekat, barrët, ngarkesat, privilegjet dhe përparësitë e çdolloji.

Seksioni 4.18. Huamarrësi do të marrë ose do të marrë masa që të merren të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që FSHZH-ja të vazhdojë të jetë në krye të ekzekutimit dhe të menaxhimit të Projektit dhe do të plotësohet në mënyrë të mjaftueshme nga personel kompetent, duke përfshirë edhe stafin e lartë menaxhues, inxhinierë dhe personel tjetër teknik, si dhe staf të specializuar në financa, prokurim dhe kontabilitet. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë më tej që FSHZH-ja të realizojë rekrutimin e stafit të duhur, sipas nevojës.

Seksioni 4.19. Principali dhe interesi mbi huan dhe të gjitha detyrimet e tjera do të paguhën pa zbritje dhe pa asnjë tatim në fuqi apo pagesa sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve në fuqi në territorin e tij, qoftë aktualisht apo në të ardhmen.

Seksioni 4.20. Kjo Marrëveshje do të jetë e lirë nga çdo taksë, tatim, pagesë, tarifa dhe detyrime të çdo natyre të vendosur sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve në fuqi në territorin e tij, qoftë aktualisht apo në të ardhmen, për ose në lidhje me ekzekutimin, lëshimin, ofrimin ose regjistrimin e saj dhe Huamarrësi do të paguajë ose do të marrë masa që të paguhën të gjitha tatimet e tilla, taksat, pagesat dhe detyrimet, nëse ka, të vendosura në bazë të ligjeve të vendit apo vendeve, në monedhën e të cilave mund të shlyhet huaja.

Seksioni 4.21. Principali dhe interesi dhe detyrimet e tjera të huas do të paguhën të lira nga të gjitha kufizimet, duke përfshirë kufizimet e këmbimit të vendosura sipas ligjeve të Huamarrësit apo të ligjeve në fuqi në territorin e tij.

Seksioni 4.22. Të gjitha dokumentet e Fondit, regjistrimet, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Huamarrësi si çështje konfidenciale dhe Huamarrësi do t'i japë Fondit imunitet të plotë nga censura dhe inspektimi i tyre.

Seksioni 4.23. Të gjitha asetet e Fondit dhe të ardhurat do të çlirohen nga shtetëzimi, sekuestrimi dhe konfiskimi.

#### Neni V

#### **Anulimi dhe pezullimi**

Seksioni 5.01. Huamarrësi, duke njoftuar Fondin, mund të anulojë çdo shumë të huas që

Huamarrësi nuk do të ketë tërhequr para dhënies së këtij njoftimi, përveçse Huamarrësi nuk mund të anulojë kështu çdo shumë të huas në lidhje me të cilën Fondi do të ketë hyrë në një angazhim të veçantë në pajtim me seksionin 3.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme duhet të ketë ndodhur dhe është duke vazhduar, duke njoftuar Huamarrësin Fondi mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja:

a) Një mosplotësim pagese do të ketë ndodhur në pagesën e principalit ose të interesit ose të ndonjë pagese tjetër të kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit;

b) Një mospërmbushje do të ketë ndodhur në kryerjen e ndonjë angazhimi ose marrëveshjeje tjetër nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) Fondi do të ketë pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje në bazë të ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje midis Huamarrësit dhe Fondit për shkak të një mospërmbushjeje nga ana e Huamarrësit;

d) Një situatë e jashtëzakonshme do të ketë lindur, e cila do të bëjë të pamundur që Huamarrësi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo ngjarje që ndodh pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe përpara datës së hyrjes në fuqi, e cila do t'i kishte dhënë të drejtë Fondit për të pezulluar të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje, nëse kjo Marrëveshje do të ishte në fuqi në datën kur ka ndodhur një ngjarje e tillë, do t'i japë të drejtë Fondit të pezullojë tërheqjet sipas huas sikur të kishte ndodhur pas datës efektive.

E drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje sipas huas do të vazhdojë të jetë e pezulluar tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa ngjarja ose ngjarjet që kanë çuar në një pezullim të tillë do të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Fondi të ketë njoftuar Huamarrësin se e drejta për të kryer tërheqje është rivendosur; me kusht që, sidoqoftë, në rastin e një njoftimi të tillë të kthimit të së drejtës për të kryer tërheqje do të rivendoset vetëm në masën dhe në bazë të kushteve të specifikuar në këtë njoftim dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose kompensim të Fondit në lidhje me ndonjë



ngjarje tjetër të mëvonshme të përshkruar në këtë seksion.

Seksioni 5.03. Nëse ndonjë ngjarje e specifikuar në paragrafin “a” të seksionit 5.02 do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej tridhjetë ditësh pas njoftimit të dhënë nga Fondi për Huamarrësin ose në qoftë se ndonjë ngjarje e specifikuar në paragrafët “b”, “c” dhe “d” të seksionit 5.02 do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit, dhënë nga Fondi për Huamarrësin, atëherë në çdo kohë të mëvonshme gjatë vazhdimit të saj, Fondi, në zgjedhjen e tij, mund të deklarojë principalin e huas të kërkueshëm dhe të pagueshëm menjëherë dhe pas çdo deklarate të tillë, principalin do të bëhet i pagueshëm menjëherë, pavarësisht ndonjë elementi të kundërt në këtë Marrëveshje.

Seksioni 5.04. Nëse: a) e drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja do të jetë pezulluar në lidhje me ndonjë shumë të huas për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë ditësh; ose b) në datën e specifikuar në seksionin 3.09 si data e mbylljes, një shumë e huas do të mbetet e patërhequr, Fondi, duke njoftuar Huamarrësin mund të ndërpresë të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje në lidhje me këtë shumë. Pas dhënies së këtij njoftimi kjo shumë e huas do të anulohet.

Seksioni 5.05. Asnjë anulim ose pezullim nga Fondi nuk do të zbatohet për shumat që i nënshtrohen ndonjë angazhimi të veçantë të parevokueshëm të lidhur nga Fondi në pajtim me seksionin 3.02, përveç kur parashikohet shprehimisht në angazhimin e tillë.

Seksioni 5.06. Përveç rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, çdo anulim do të zbatohet proporcionalisht në disa këste të principalit kryesor të huas së maturuar pas datës së një anulimi të tillë.

Seksioni 5.07. Pavarësisht nga çdo anulim ose pezullim, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç kur parashikohet në mënyrë specifike në këtë seksion.

## Neni VI

### **Zbatueshmëria e kësaj Marrëveshjeje; mosushtrimi i të drejtave; arbitrazhi**

Seksioni 6.01. Të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në pajtim me kushtet e tyre, pavarësisht ndonjë ligji vendës për të

kundërtën. As Huamarrësi dhe as Fondi nuk kanë të drejtë në asnjë rrethanë të pohojnë ndonjë pretendim që ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme ose e pazbatueshme për çfarëdo arsye.

Seksioni 6.02. Asnjë vonesë në ushtrimin ose mosveprimin për të ushtruar ndonjë të drejtë, kompetencë apo zgjidhje ligjore që rrjedh për të dyja palët sipas kësaj Marrëveshjeje për çdo mospërmbushje, nuk do të pengojë atë të drejtë, kompetencë ose mjet të tillë ose nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj, ose pranim i heshtur i një mospërmbushjeje të tillë dhe as veprimi i asaj pale në lidhje me çdo mospërmbushje apo pranim të heshtur në çdo mospërmbushje, nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose zgjidhje të kësaj pale në lidhje me ndonjë mospërmbushje tjetër ose vijuese.

Seksioni 6.03. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga secila palë kundër tjetrës që rrjedh nga kjo Marrëveshjeje do të zgjidhet me marrëveshje të palëve dhe me dështimin e një marrëveshjeje të tillë, konflikti ose pretendimi do të paraqitet në arbitrazh nga një Gjykatë Arbitrazhi, siç parashikohet në seksionin në vijim.

Seksioni 6.04. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitra të caktuar si vijon: një arbitër do të caktohet nga Huamarrësi; arbitri i dytë do të caktohet nga Fondi; dhe arbitri i tretë (në tekstin në vijim i referuar ndonjëherë si Arbitri) do të caktohet me marrëveshje të palëve. Në rast se ndonjë arbitër i emëruar në përputhje me këtë seksion do të japë dorëheqjen, vdes ose bëhet i paaftë për të vepruar, një arbitër pasardhës do të emërohet në të njëjtën mënyrë të përshkruar më parë për emërimin e arbitrit fillestar dhe pasardhësi i tillë do të ketë të gjitha kompetencat dhe detyrat e këtij arbitri fillestar.

Procedimet e arbitrazhit mund të kenë lindur në bazë të këtij seksioni pas njoftimit nga njëra palë për tjetrën. Ky njoftim duhet të përmbajë një deklaratë që përcakton natyrën e debatit ose të pretendimit që do të paraqitet për arbitrazh, natyrën dhe shtrirjen e zgjidhjes së kërkuar dhe emrin e arbitrit të emëruar nga pala që fillon këto procedura.

Brenda tridhjetë ditëve pas dhënies së këtij njoftimi, pala tjetër do ta njoftojë palën që fillon



procedurat për emrin e arbitrit të caktuar nga pala tjetër dhe në pamundësi të kësaj, një arbitër i tillë do të caktohet nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e palës që fillon procedimet.

Nëse brenda gjashtëdhjetë ditëve pas dhënies së njoftimit për hapjen e procedurave të arbitrazhit, palët nuk kanë rënë dakord për Arbitrin, secila palë mund t'i kërkojë Kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të emëruar një Arbitër.

Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet për herë të parë në kohën dhe vendin që është përcaktuar nga Arbitri. Pas kësaj, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë se ku dhe kur do të mblidhet.

Në bazë të dispozitave të këtij seksioni dhe përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë të gjitha çështjet në lidhje me kompetencën e saj dhe do të përcaktojë procedurën e saj në mënyrë që të përballojë një dëgjim të drejtë për çdo palë dhe do të përcaktojë çështjet e paraqitura në të, qoftë nëse të dyja palët paraqiten para saj ose në mungesë të paraqitjes së njëres prej tyre. Vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të jenë me shumicën e votave dhe ajo do ta japë vendimin e saj me shkrim. Dhënia e tillë do të nënshkruhet të paktën nga shumica e anëtarëve të Gjykatës së Arbitrazhit dhe një kopje e nënshkruar e saj do t'i transmetohet çdo pale. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit i dhënë në pajtim me dispozitat e këtij seksioni do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët që duhet t'i përmbahen dhe të jenë në përputhje me dhënien e tillë.

Palët do të caktojnë shumën e shpërblimit apo tarifave të arbitrazhit dhe të personave të tjerë siç do të kërkojnë për kryerjen e procedurave të arbitrazhit. Nëse palët nuk bien dakord për një shumë të tillë para se Gjykata e Arbitrazhit të mblidhet, Gjykata e Arbitrazhit do të caktojë një shumë të tillë që do të jetë e arsyeshme sipas rrethanave. Çdo palë do të mbulojë shpenzimet e veta në procedurat e arbitrazhit. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen ndërmjet dhe do të përballohen në mënyrë të barabartë nga palët. Çdo çështje në lidhje me ndarjen e shpenzimeve të Gjykatës së Arbitrazhit ose procedura për pagesën e shpenzimeve të tilla do të përcaktohet nga Gjykata e Arbitrazhit.

Gjykata e Arbitrazhit do të zbatojë parimet e përbashkëta sipas ligjeve aktuale të Huamarrësit dhe shtetit të Kuvajtit, si dhe parimet e drejtësisë.

Seksioni 6.05. Dispozitat për arbitrazhin e përcaktuara në seksionin e mëparshëm do të jenë në vend të çdo procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga secila palë ndaj palës tjetër që rrjedh prej saj.

Seksioni 6.06. Dërgimi i çdo njoftimi ose kryerja e procesit në lidhje me procedurat në bazë të këtij neni, mund të kryhet në mënyrën e parashikuar në seksionin 7.01. Palët e kësaj Marrëveshjeje mund të heqin dorë nga të gjitha kërkesat e tjera për dërgimin e ndonjë njoftimi apo kryerjen e një procesi të tillë.

#### Neni VII

#### Dispozita të ndryshme

Seksioni 7.01. Çdo njoftim ose kërkesë që kërkojnë ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në seksionin 8.03, njoftimi apo kërkesa e tillë do të konsiderohet se është dhënë ose bërë rregullisht, nëse dërgohet dorazi ose me postë ose faks për palën për të cilën kërkojnë ose lejohet të jepet ose bëhet në adresën e tillë të palës të specifikuar në këtë Marrëveshje ose në një adresë tjetër që një palë e tillë do të ketë caktuar me anë të njoftimit për palën tjetër, duke dhënë këtë njoftim ose duke bërë një kërkesë të tillë.

Seksioni 7.02. Huamarrësi do t'i japë Fondit prova të mjaftueshme të autoritetit të personit ose personave që do të nënshkruajnë aplikimet e parashikuara në nenin III ose që, në emër të Huamarrësit, do të marrë ndonjë veprim tjetër apo do të nënshkruajë ndonjë dokument tjetër të nevojshëm ose që lejohet të merret ose nënshkruhet nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe modelin e vërtetuar të nënshkrimit të çdo personi të tillë.

Seksioni 7.03. Çdo veprim që kërkojnë ose lejohet që të merret dhe të gjitha dokumentet që kërkojnë ose lejohen për t'u nënshkruar sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit mund të merren ose nënshkruhen nga ministri i Financave të Huamarrësit ose çdo person i autorizuar me shkrim prej tij. Çdo modifikim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të bihet





dakord në emër të Huamarrësit me dokument të shkruar të ekzekutuar në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesi i tij i sipërpërmendur, me kusht që sipas mendimit të përfaqësuesit, një ndryshim apo përforsim i tillë të jetë i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë ndjeshëm detyrimet e Huamarrësit, sipas kësaj Marrëveshjeje. Fondi mund të pranojë nënshkrimin me përfaqësues të tillë apo person tjetër të ndonjë dokumenti të tillë si dëshmi bindëse se sipas opinionit të këtij përfaqësuesi, çdo modifikim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje i kryer nga një instrument i tillë është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë ndjeshëm detyrimet e Huamarrësit.

#### Neni VIII

##### Hyrja në fuqi; përfundimi

Seksioni 8.01. Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Fondit t'i jenë dhënë prova të kënaqshme që nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare.

Seksioni 8.02. Si pjesë e provave që do të dërgohen në pajtim me seksionin 8.01, Huamarrësi do t'i japë Fondit një opinion ose opinione të lëshuar/a nga ministri i Drejtësisë që tregojnë se kjo Marrëveshje është autorizuar ose ratifikuar ligjërisht dhe nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 8.03. Përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga Fondi dhe Huamarrësi, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Fondi i dërgon me postë apo faks Huamarrësit njoftim për pranimin e provave të kërkuara nga seksioni 8.01.

Seksioni 8.04. Nëse të gjitha aktet e nevojshme që duhet të kryhen në pajtim me seksionin 8.01 nuk do të jenë kryer para (150) ditëve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose në ndonjë datë tjetër që do të bihet dakord nga Fondi dhe Huamarrësi, Fondi në çdo kohë pas kësaj, në gjykimin e tij mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Huamarrësin. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj do të përfundojnë menjëherë.

Seksioni 8.05. Nëse dhe kur e gjithë shuma e principalit të huas dhe i gjithë interesi dhe detyrimet e tjera, të cilat do të jenë llogaritur mbi huan do të

jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj, do të përfundojnë menjëherë.

#### Neni IX

##### Përkufizimet

Seksioni 9.01. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime, kudo që përdoren në këtë Marrëveshje ose çdo shtojcë të saj:

1. Termi “Projekt” do të thotë projekti për të cilin është dhënë huaja, siç përshkruhet në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç përshkrimi i tij do të ndryshohet nëse është i nevojshëm me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

2. Termi “Mallra” nënkupton pajisjet, furnizimet, shërbimet dhe punët që kërkohen për Projektin. Kudo që i bëhet referencë kostos së çdo malli, një kosto e tillë do të konsiderohet të përfshijë koston e importimit të mallrave të tilla në territorin e Huamarrësit.

3. Termi “FSHZH” do të thotë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili rregullohet me ligjin nr. 10 130, të datës 11.5.2009.

4. Termi “Marrëveshje partneriteti” nënkupton marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Financave dhe FSHZH-së, për të bërë të ardhurat e huas të disponueshme për FSHZH-në, në formë granti dhe në terma dhe kushte të kënaqshëm për Fondin.

5. Termi “ARSH” do të thotë Autoriteti Rugor Shqiptar, i cili rregullohet me ligjin nr. 10 164, datë 15.10.2009.

6. Udhëzimet e Prokurimeve të Fondit të Kuvajtit do të thotë Udhëzuesi për Prokurimin e Mallrave dhe Kontraktimi për Kryerjen e Punimeve – Botimi 2001.

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 7.01:

##### Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Adresa alternative për fakset dhe postën elektronike:

FAKS

E-MAIL

+35542228494

sekretariamin@financa.gov.al

##### Për Fondin:

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab



Kutia Postare 2921, Safat  
Kuvajt - 13030

Adresa alternative për fakset dhe postën elektronike:

FAKS E-MAIL  
(965) 22999190 operations@kuwait-fund.org  
(965) 22999091

Në dëshmi sa më sipër, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar ligjërish, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në emrat e tyre përkatës dhe kanë dorëzuar në Tiranë, në dy kopje, secila e konsideruar si origjinale dhe të dyja për të njëjtin efekt, si në ditën dhe vitin e shkruar më lart.

Republika e Shqipërisë  
Nga:.....  
(përfaqësuesi i autorizuar)

Fondi Kuvajtian për  
Zhvillimin Ekonomik Arab  
Nga:.....  
(përfaqësuesi i autorizuar)

### SHTOJCA 1 DISPOZITAT E SHLYERJES

Shuma e principalit e tërhequr nga huaja do të paguhet në 38 këste gjashtëmujore, shuma dhe renditja e secilit, siç përcaktohet në tabelën bashkëlidhur. I pari prej këtyre kësteve do të jetë i pagueshëm në datën e parë në të cilën çdo interes apo pagesat e tjera të kredisë do të bëhen të pagueshme, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huas, pas kalimit të një periudhe pa pagesë principali prej 5 vitesh, duke filluar nga data në të cilën Fondi paguan ndonjë shumë nga huaja sipas aplikimit të parë për tërheqje të kryer nga Huamarrësi ose nga data kur Fondi lëshon një sipërmarrje në pajtim me seksionin 3.02 të Marrëveshjes së Huas, në rast se aplikimi i tërheqjes së parë kërkon lëshimin e një sipërmarrjeje të tillë, cilado që është më herët nga dy datat. Këstet e mbetura për shlyerjen e principalit do të jenë të njëpasnjëshme, çdo gjashtë muaj, pas datës në të cilën duhet të paguhet kësti i parë.

### SKEDULI PËR SHTOJCËN 1 SKEDULI I AMORTIZIMIT

Nr.	Data e pagesës përkatëse	Pagesa e principalit (shprehur në dinarë kuvajtianë)
1		315,700
2		315,700
3		315,700
4		315,700
5		315,700
6		315,700
7		315,700
8		315,700
9		315,700
10		315,700
11		315,700
12		315,700
13		315,700
14		315,700
15		315,700
16		315,700
17		315,700
18		315,700
19		315,700
20		315,700
21		315,700
22		315,700
23		315,700
24		315,700
25		315,700
26		315,700
27		315,700
28		315,700
29		315,700
30		315,700
31		315,700
32		315,700
33		315,700
34		315,700
35		315,700
36		315,700
37		317,400
38		317,400
<b>TOTALI</b>		<b>12,000,000</b>
(Dymbëdhjetë milionë dinarë kuvajtianë)		

### SHTOJCA 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti do të kontribuojë në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe social të rajonit të Vlorës, nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të transportit të udhëtarëve dhe mallrave që do të reduktojë kohën e udhëtimit dhe minimizojë koston e transportit, përveç ofrimit të sigurisë në trafik. Projekti përfshin punimet civile për rishtimin e rrugës kryesore ekzistuese 74 km Vlorë–Peshkepi–Qeparo dhe zgjerimin e saj në një rrugë me dy drejtime me 3.75 m gjerësi dhe 0.75 m anë xhadeje



për çdo rrugë. Projekti përfshin edhe vepra të rehabilitimit për strukturat e kullimit, të sigurisë dhe të ndriçimit përveç vendkalimit të këmbësorëve që përshkrijnë qytetet kryesore përgjatë rrugës, si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme të konsulencës për skicim, dokumentet e tenderit, të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve.

Projekti përfshin komponentët kryesorë të mëposhtëm:

1. Përgatitja e punimeve në vendin e punës.
2. Shtrimi i sipërfaqes.
3. Rehabilitimi i kullimit, siguria dhe ndriçimi, duke përfshirë edhe veprat e ndryshme.
4. Shërbime konsulente në lidhje me inxhinierinë.

Projekti pritet të fillojë në fillim të vitit 2016 dhe të përfundojë në fund të vitit 2019.

### SHTOJCA 3

#### LISTA E MALLRAVE QË DO TË FINANCOHEN NGA HUAJA DHE METODAT DHE PROCEDURAT PËR PROKURIM

1. Artikujt që do të financohen nga huaja dhe shpërndarja për çdo njësi dhe përqindja e shpenzimeve që do të financohen në këtë mënyrë caktohen si në “Listën e mallrave” bashkëlidhur. Është rënë dakord në këtë mënyrë ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, se nëse të dyja palët zbulojnë se shpërndarja për çdo njësi është e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e përcaktuar në listën e përmendur të mallrave të kostos së pritshme të kësaj njësie, ata mund të marrin ndonjë nga këto masa:

a) të alokojnë për atë njësi, brenda kufirit të shumës së nevojshme për të mbuluar mungesën në financim në bazë të përqindjes së caktuar, një shumë shtesë kundrejt fondit të alokuar për zëra të paparashikuar në “Listën e mallrave” apo kundrejt shpërndarjes për çdo njësi tjetër ku ka tepriçë në atë shpërndarje.

b) të zvogëlojë përqindjen që do të financohet nga huaja të kostos së përgjithshme të njësisë të caktuar, nëse shpërndarja shtesë për atë njësi, në përputhje me sa më sipër, është e pamjaftueshme për të mbuluar mungesën e përmendur më sipër ose nëse të dyja palët janë të mendimit se nuk është e mundur që të alokohet ndonjë shumë shtesë prej huas për këtë njësi, në mënyrë që si pasojë e një zvogëlimi të tillë, tërheqje nga huaja do të

vazhdojnë për financimin e kostos së mallrave, punimeve ose shërbimeve të përfshira në këtë njësi derisa kostoja e tyre totale të jetë mbuluar plotësisht.

2. Huamarrësi bie dakord që të ardhurat e huas nuk do të përdoren për pagimin e çfarëdo takse apo detyrimi të vendosur sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Huamarrësi, gjithashtu, bie dakord që të gjitha njësitë që do të financohen nga huaja do të grupohen në paketa të përshtatshme nga pikëpamja e llojit dhe madhësisë, me qëllim që të lehtësojnë, në masën e mundshme, marrjen e ofertave të tenderit të hapur ndërkombëtar (ICB). Përveç kur këtu është shprehur ndryshe ose bihet dakord me Fondin, procedura e tenderimit konkurrues ndërkombëtar do të përdoret për prokurimin e të gjitha njësive të tilla.

4. Në lidhje me shërbimet e konsulencës të kërkuara për punimet, këto shërbime do të prokurohen në përputhje me Udhëzimet e Fondit për Përdorimin e Konsulentëve, si dhe procedurat e deklaruara në këtë shtojcë. Një listë e përzgjedhur e të paktën 6 (gjashtë) konsulentëve kuvajtianë dhe një numër i ngjashëm i konsulentëve lokalë do të përgatitet në marrëveshje me Fondin dhe konsulentët në listën e përzgjedhur do të ftohen për të paraqitur propozimet e tyre. Konsulenti kuvajtian dhe shqiptar do të ftohen të dorëzojnë ofertat e tyre në bashkëpunim me njëri-tjetrin, d.m.th. bashkërisht ose secili veçmas. Për qëllim të kërkesave të mësipërme, një konsulent nuk do të konsiderohet si kuvajtian apo shqiptar, përveç kur firma e tij është e bazuar në secilin vend dhe në pronësi me një masë prej jo më pak se 51% nga shtetas të Kuvajtit ose Shqipërisë. Ftesa e propozimeve do të bëhet në bazë të termave të referencës të rënë dakord me Fondin dhe letra e ftesës do të kërkojë dorëzimin e propozimeve teknike dhe financiare në zarfe të veçanta. Propozimet teknike do të hapen më parë dhe vlerësohen dhe më pas propozimet financiare duhet të hapen dhe do të kryhet një vlerësim i kombinuar teknik dhe financiar. Vlerësimi në çdo fazë do të kryhet në përputhje me kriteret e miratuara me Fondin paraprakisht dhe të përcaktuara në ftesën e propozimeve.

5. Tenderët për ndërtimin e veprave do të prokurohen në bazë të ofertave ndërkombëtare konkurruese (ICB). Njoftimi i ftesës për



kontraktuesit e interesuar që të paraqesin ofertat e tyre do të botohet në të paktën një gazetë periodike ndërkombëtare, dy gazeta të përditshme kuvajtiane dhe të paktën në një gazetë lokale. Pas marrjes së ofertave, një raport për vlerësimin teknik dhe financiar të ofertave duhet të përgatitet dhe të dorëzohet te Fondi për shqyrtim dhe miratim nga Fondi, së bashku me rekomandimin për dhënien. Në rast se është e nevojshme për të kryer bisedime me ofertuesin e zgjedhur, drafti i kontratës përfundimtare që del nga këto bisedime do t'i dërgohet Fondit për miratim.

6. Për sa i përket zbatimit të seksionit 4.06 të Marrëveshjes së huas dhe prokurimit të të gjitha njësive të mallrave dhe punimeve që do të

financohen nga huaja, procedura për të ftuar ofertat, si dhe draftdokumentet për tenderin për prokurimin e këtyre mallrave dhe punimeve do t'i vihen në dispozicion Fondit për shqyrtim dhe miratim dhe do të kryhen ndryshimet e arsyeshme që mund të kërkohen nga Fondi në dokumente të tilla ose në procedurat e tenderimit.

7. Pas nënshkrimit të çfarëdo kontrate që do të financohet nga huaja, një original ose kopje e konfirmuar dhe e vërtetuar e kontratës do t'i dërgohet Fondit për të dhënat e tij dhe për qëllimin e disbursimeve nga huaja. Çdo ndryshim material i propozuar për t'u bërë në ndonjë kontratë do të paraqitet pranë Fondit për miratim.

#### LISTA E MALLRAVE

SI. Nr.	Njësia	Shpërndarja e të ardhurave (dinarë kuvajtianë)	Përqindja ndaj kostos totale të njësisë
1	Ndërtimi i punimeve civile	9,913,000	77%
2	Shërbimet e konsulencës	777,000	100%
3	Zërat e paparashikuar të pashpërndarë	1,310,000	
<b>TOTALI</b>		<b>12,000,000</b>	
		<b>(Dymbëdhjetë milionë dinarë kuvajtianë)</b>	

#### SHTOJCA 4

Huamarrësi pranon se ai ka qenë i informuar siç duhet që në përputhje me rregullat në fuqi në shtetin e Kuvajtit, përdorimi i fondeve publike në lidhje me transaksionet që përfshijnë ndonjë firmë apo shoqëri që i nënshtrohet bojkotit sipas këtyre rregullave, është i ndaluar.

Huamarrësi, pra, merr përsipër që të ardhurat e huas nuk do të përdoren në asnjë mënyrë për të financuar drejtpërdrejt ose tërthorazi çfarëdo mallrash apo shërbimesh të prodhuara apo të furnizuara nga ndonjë vend, firmë apo subjekt që i nënshtrohet bojkotit sipas rregullave në fuqi në shtetin e Kuvajtit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë